



ÇFARË NDODH ME FAMILJET DHE FËMIJËT SHQIPTARË TË KTHYER?

*Gjetjet kryesore nga vlerësimi i aksesit në shërbime
për migrantët e kthyer në Tiranë, Dibër dhe Fier*

Maj 2017



WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



ÇFARË NDODH ME FAMILJET DHE FËMIJËT SHQIPTARË TË KTHYER?

*Gjetjet kryesore nga vlerësimi i aksesit në shërbime
për migrantët e kthyer në Tiranë, Dibër dhe Fier*

Ky vlerësim i referohet informacionit të mbledhur gjatë periudhës Mars – Prill 2017 nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori) nëpërmjet intervistave me institucionet qendrore, lokale dhe ofruesit e shërbimeve si dhe nëpërmjet fokus grupeve me emigrantët të kthyer, në qarkun e Dibrës, Fierit dhe Tiranës. Iniciativa për realizimin e këtij vlerësimi është realizuar në bashkëpunim me Agjensinë Austriake për Zhvillim (ADA).

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk shpreh domosdoshmërisht opinionin e ADA.

©Observatori/ ADA, Maj 2017

ÇFARË NDODH ME FAMILJET DHE FËMIJËT SHQIPTARË TË KTHYER?

Gjetjet kryesore nga vlerësimi i aksesit në shërbime për migrantët e kthyer në Tiranë, Dibër dhe Fier

HYRJE

Numri i emigrantëve shqiptarë që kthehen në vend ka qënë në rritje që nga viti 2015 kur Shqipëria u klasifikua si “një vend i sigurt origjine” nga Bashkimi Evropian. Një numër i konsiderueshëm i emigrantëve shqiptarë të sapo kthyer janë fëmijë, ose si pjesëtarë të familjeve¹, ose të pashoqëruar (numri më i madh i të pashoqëruarve vjen nga Gjermania, Franca, Suedia dhe Holanda²).

Ekzistojnë të dhëna në lidhje me emigrimin masiv nga Shqipëria dhe efektet e tij tek ekonomia e vendit, komunitetet rurale dhe urbane, si dhe tek familjet dhe fëmijët, por shumë më pak literaturë gjendet në lidhje me emigrantët që kthehen. Shkalla e lartë e emigrimit do të thotë se shkalla dhe ndikimi i prirjes së saj të kundërt ka të ngjarë të jetë shumë më e madhe. Vetëm tre për qind e kërkesave për azil të emigrantëve shqiptarë në vendet e tjera evropiane janë pranuar gjatë periudhës 2015 (tremujori i tretë) dhe 2017 (tremujori i parë)³, dhe në vitin 2015 Gjermania pranoi vetëm 55 nga 23,300 kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë (më pak se 0.25 për qind)⁴.

Vlerësimi i ndërmarrë nga UNICEF në Shqipëri ka nxjerrë në dritë se pas kthimit në atdhe, familjet dhe fëmijët emigrantë mund të përballen me një realitet të vështirë, që vështirëson ri-integrimin e tyre, edhe në fushat e arsimit, mbrojtjes sociale dhe punësimit⁵. Hulumtimi i mëparshëm i Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve⁶ (Observatori) ka vërejtur problemet që institucionet vendore/lokale në Shqipëri hasin në identifikimin dhe arritjen e të kthyerve.

Hulumtimi që prezantohet në këtë raport përmbledhës, i ndërmarrë nga Observatori, me mbështetjen e Agjencisë Austriake të Zhvillimit, fokusohet në një çështje të rëndësishme dhe të vetme - çfarë ndodh me familjet emigrante, veçanërisht me fëmijët e tyre, kur ata kthehen në Shqipëri. Hulumtimi

¹ UNICEF në Shqipëri dhe Observatori (2015). *Emigrimi masiv i qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të BE-së dhe kapaciteti i njësive të reja administrative dhe njësive funksionale për të përballuar nevojat e emigrantëve të kthyer*. E disponueshme në: <http://observator.org.al/sq/shqyrtim-rasti-emigrimi-masiv/>

² Informacion nga Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, Prill 2017

³ Eurostat 2017 Asylum Quarterly Report, I disponueshëm në: <http://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/publications>

⁴ Hackaj, A, Shehaj, E. & Zeneli, N. (2016) *Comprehending Albanian migration to Germany in the period 2014-2016*, p.12. (Working paper Berlin Process series 2/2016.)

⁵ Shanaj, H., Hallkaj, E. & Cuninghame, C. Child Notice Albania (2015), Tirane:UNICEF në Shqipëri, fq.84.

⁶ UNICEF në Shqipëri dhe Observatori. Nëntor 2016. *Migrantët e kthyer shqiptarë: një vështrim i përgjithshëm i manaxhimit të të dhënave me fokus fëmijët*. E disponueshme në: <http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/12/Vezhgim-rasti-06-12-2016.pdf>

përqëndrohet rreth shërbimeve publike kryesore për të cilat këto emigrantë kanë nevojë që nga fillimi i procesit të dëshiruar të ri-integrimit të tyre në shoqërinë shqiptare.

Hulumtimi u krye në tri rajone të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Dibër dhe Fier. Tirana, gjeografikisht në qendër të vendit, u zgjodh duke qenë më i populluari dhe, me aeroportin e vetëm ndërkombëtar, i njohur si destinacioni kryesor i kthimit të emigrantëve në vend. Dibra, në veri-lindje, është një nga zonat më të varfra të vendit, me më shumë se gjysmën e fëmijëve të moshës 6-15 vjeç të mbështetur me Ndhmë Ekonomike, si dhe me shifra të larta të të kthyerve nga emigrimi. Fieri, në jug-perëndim, është rajoni më i madh i Shqipërisë referuar territorit të tij dhe renditet i dyti pas Tiranës për sa i përket emigrimit dhe kthimit.

Hulumtimi targetoi institucione të lidhura me shërbime që kanë të bëjnë me migracionin, regjistrimin civil, përkujdesin shoqëror, punësimin, shëndetësinë dhe arsimin. Mbledhja e të dhënave u krye nëpërmjet pyetësorëve dërguar të gjithë përfaqësuesve të këtyre shërbimeve, në nivel kombëtar⁷, rajonal dhe vendor/lokal. U zhvilluan gjithashtu intervista me ofruesit e shërbimeve në nivel rajonal dhe lokal, si edhe dhjetë fokus grupe me familje të kthyer nga emigracioni (të gjithë të rritur, nga zonat e targetuara), të cilët u konsultuan në lidhje me përvojat e tyre në përfitimin e shërbimeve. Shumica e familjeve kishin emigruar ose qëndruar në mënyrë të paligjshme në vende të ndryshme. Procesi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave u ndërmor gjatë periudhës kohore Mars-Prill 2017.

Nëpërmjet kësaj përmbledhjeje, Observatori ofron disa sugjerime dhe rekomandime praktike, për të motivuar punën e mëtejshme ndër hartuesit e politikave në nivel kombëtar dhe lokal, me qëllim nxitjen e ri-integrimit të emigrantëve që kthehen në Shqipëri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur flitet për fëmijët, në mënyrë që gjasat e tyre për ri-integrim afatgjatë të rriten. Gjetjet e nxjerra nga hulumtimi prezantohen sipas shërbimeve kryesore, dhe rekomandimet targetojnë institucionet e nivelit qendror, por përfshijnë masa që lidhen edhe me institucionet në varësi, në nivel rajonal e vendor.

GJETJET KRYESORE



1. Shërbimet kufitare dhe lokale të pritjes

Pika e parë e kontaktit për familjet dhe fëmijët e kthyer është Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin (në varësi të Ministrisë së Punëve

⁷ Ministrinë e linjës (me departamentet e tyre respektive) janë: (1) Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti i Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile) (2) Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (Departamenti i Shërbimit Social Shtetëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve) (3) Ministria e Arsmi dhe Sportit (4) Ministria e Shëndetësisë

të Brendshme, MPB) në pikat kufitare shqiptare. Gjatë fokus grupeve, emigrantët e kthyer u shprehën se nuk mund të kujtonin përvojën e shërbimit të marrë në kufi, duke përmendur faktin se ky moment ishte i ngarkuar emocionalisht për ta.

Në rastin e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore (në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, MMSR) është institucion që përfshihet në proces. Ky institucion kryen intervista dhe vëzhgime tek familja e fëmijës për të vlerësuar kushtet socio-ekonomike në saj, si edhe gatishmërinë e familjarëve për të pritur fëmijën. Ky proces vlerësimi kërkon kohë dhe autoritetet në vendin pritës njoftohen, në mënyrë që të mund të marrin masa për të siguruar mirëqenien e fëmijës.

Gjatë hulumtimit doli në dukje se disa vende (të huaja) nuk i njoftojnë autoritetet shqiptare në kohë që të mund të realizohen kontrollet/masat e duhura para kthimit të fëmijës. Në këto raste, policia kufitare organizon strehimin fillestar të fëmijës. Në të tre rajonet, Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin konfirmuan se ndjekin procedurat së bashku me Shërbimet Sociale Shtetërore për fëmijët e pashoqëruar. Gjithsesi, hulumtimi nuk mundi të eksploronte më tej sesi përputhej kjo me përvojat e familjeve dhe fëmijëve.

36 (tridhjetë e gjashtë) Sportelet e Migracionit (numri i tyre korespondonte me ndarjen e vendit në rrethe) u krijuan me qëllim që të jenë pika e parë hyrëse për të kthyerit, për të lehtësuar ri-integrimin e tyre duke i referuar ata në shërbimet e tjera. Ato u themeluan në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin, dhe menaxhohen në nivel qendror nga MMSR. Fizikisht ato gjenden pranë godinave të Zyrave të Punës. Në praktikë, funksioni kryesor i këtyre sporteleve është i njëjtë atë të Zyrave të Punës - mbështetje në sigurimin e një vendi pune. Këto sportele janë kritikuar më parë se nuk kanë qenë mjaft proaktivë⁸, dhe shumica e familjeve pjesëmarrëse në fokus grupe në këtë hulumtim thanë se nuk kishin dëgjuar asnjëherë për ekzistencën e tyre.



2. Regjistrimi Civil

Funksioni kryesor i zyrave të gjendjes civile (menaxhuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, dhe të vendosura në 61 bashkitë dhe njësitë administrative në varësi të tyre) është të regjistrojnë fëmijët që kanë lindur jashtë vendit. Disa probleme u identifikuan në këto raste, kryesisht në rastet e emigrantëve të paligjshëm të kthyer nga Greqia që kanë lindur fëmijë atje pa u pajisur me dokumentacion e plotë nga autoritetet greke, duke hasur si rrjed-

⁸ Gjojutaj, E. & Hroni, E (2013). Stories behind visa liberalisation: asylum seekers and visa liberalisation. (s.l.): European Fund for the Balkans.

hojë sfida në regjistrimin e tyre në gjendjen civile ⁹.

Shumë familje që kthehen nga emigracioni kontaktojnë zyrat respektive të gjendjes civile për të marrë dokumentacionin e duhur që u mundëson atyre përfitim/aksesin e shërbimeve të tilla si mbështetja sociale, kujdesi shëndetësor dhe shkollimi. Duke qënë se zyrat e gjendjes civile mbajnë rekorde vetëm për shtetasit shqiptarë të regjistruar (jo të gjithë banorët/rezidentët aktualë), mungesa e të dhënave zyrtare mund të krijojë vështirësi për disa nga ata që sapo janë kthyer. Për shembull, nëse gjendja civile nuk ka njoftuar autoritetet arsimore se një fëmijë i kthyer duhet të regjistrohet në shkollë, fëmija mund të mos jetë në gjendje të marrë arsimimin në kohë.



3. Shërbimet Sociale

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMF), në varësi të MMSR, nuk ka marrë ndonjë udhëzim specifik përse i përket këtij grupi. Megjithatë, ASHMF ka potencialin e duhur për të adresuar nevojat e fëmijëve emigrantë të kthyer, duke qënë se kjo agjensi mbikqyr Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), të vendosura në 61 bashkitë, dhe të mandatuara për të punuar me fëmijët në rrezik. NJMF-të kanë përgjegjësinë të sigurojnë që çdo fëmijë të marrë trajtim të barabartë në të gjithë shërbimet për të cilat mund të kenë nevojë, si dhe mund të shërbejnë si urë lidhëse midis shërbimeve të ndryshme. Vlerësimi i kapaciteteve të tyre për të marrë/zbatuar këtë rol mund të jetë pjesë e kërkimeve të mëtejshme.

Informacioni mbi ofrimin e shërbimeve sociale është marrë nga departamentet e shërbimit social të bashkive, nga Drejtoria e Përgjithshme dhe ato Rajonale të Shërbimeve Sociale Shtetërore (SHSSH). Përse i përket shërbimeve të kujdesit dhe mbështetjes sociale, këto institucione i trajtojnë familjet dhe fëmijët që kthehen në të njëjtën mënyrë si pjesa tjetër e popullatës. Ndërsa, përgjegjësitë e tyre specifike për kthimin e fëmijëve të pashoqëruar tashmë janë përshkruar. Terre des Hommes dhe Save the Children gjithashtu bashkëpunojnë me SHSSH për të vlerësuar rrethanat familjare të fëmijëve të pashoqëruar dhe për t'i referuar nevojat e tyre në institucionet përkatëse.

Një problem i rëndësishëm u identifikua për çdo migrant të kthyer që ka qenë larg për më shumë se tre muaj. Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupe konfirmuan se për të përfituar nga pagesa e Ndihmës Ekonomike, ata duhej të fillonin aplikimin nga e para. Kjo ishte problematike për emigrantët e kthyer, gjendja financiare e të cilëve kishte të ngjarë të ishte më e keqe sesa në kohën kur u larguan, pasi kishin shpenzuar kursimet e tyre për të udhëtuar jashtë.

⁹ Në fokus grupe u përmendën nga pjesëmarrësit rastet kur autoritetet greke nuk e regjistronin fëmijën me emër por vetëm vendosnin 'foshnjë' në dokumenta dhe jepnin prindërve dokumente të pafirmosura të cilat nuk mund të përdorëshin në vende të tjera.



*"KAM MARRË BORXH PËR TË UDHËTUAR DHE NUK KAM MUNDUR TA PAGUAJ
AKOMA BORXHIN PASI NUK KEMI FITUAR ASGJË ATJE"*

BANOR I DIBRËS



Ligji i ndryshuar mbi Ndihmën Ekonomike nuk priorizon të kthyerit¹⁰.



4. Shërbimet e Punësimit

Sipas Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Punësimit, të kthyerit nga emigracioni duhet të trajtohen me prioritet kur regjistrohen për punësim. Nevoja për të gjetur një punë ishte një shqetësim kryesor i shprehur nga emigrantët e kthyer, pjesë e këtij hulumtimi. Disa nga të kthyerit thanë se kishin marrë këshilla punësimi nga Zyrat e Punës, ose ishin regjistruar si të papunë (duke patur mundësinë të përftonin pagesën e papunësisë).

Sidoqoftë, asnjë nga punonjësit e stafit nuk përmendi përparësitë e rasteve të të kthyerve. Në disa raste, pjesëmarrësit në fokus grupe u ankuan se nuk kishin marrë asnjë përgjigje nga këto zyra. Terre des Hommes dhe Save the Children ofrojnë disa kurse profesionale dhe mbështetje për fillimin e bizneseve për familjet me vështirësi ekonomike.



5. Shërbimet e arsimit

Për vitin akademik 2014-1025, 2062 fëmijë u kthyen nga emigracioni dhe u regjistruan në shkollë. Në vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, u regjistruan respektivisht 1800 dhe 930 fëmijë të kthyer nga emigracioni¹¹. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka dërguar udhëzime të hollësishme për të gjitha Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrat Arsimore në lidhje me mënyrën e menaxhimit të pranimeve në shkolla dhe ofrimin e mbështetjes për fëmijët e kthyer¹².

Disa nga udhëzimet e MAS nuk presin raportim përse i përket zbatimit të tyre, që do të thotë se ata mund të mos sjellin rezultatet e pritura. Aktualisht, DAR dhe ZA pritët vetëm të konfirmojnë numrin e fëmijëve të kthyer dhe të regjistruar në shkollë. Mësuesit në të tri zonat e targetuara thanë se nuk ishin udhëzuar se si të zbatojnë planet arsimore individuale me të cilët duhet të pajisen të gjithë fëmijët që kthehen dhe se nuk kishin marrë udhëzime se si të menaxhonin rastet kur prindërit e kthyer nuk kishin regjistruar fëmijë në shkollë.

¹⁰ Ligji Nr. 44/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar

¹¹ MAS, Prill 2017

¹² Ministria e Arsimit dhe Sportit, Udhëzimi nr. 9242, datë 10.11.2015 "Për regjistrimi dhe trajtimin e fëmijëve të kthyer" nr. 9242, datë 10.11.2015

Gjatë intervistave në shkolla në kuadër të këtij hulumtimi u konstatua, për shembull, se planet arsimore individuale të planifikuara për fëmijët e kthyer përfshinin vetëm detyra shtëpie ose ushtrime shtesë pas orëve të zakonshme të mësimi, por pa realizuar orë shtesë në fundjavë ose gjatë pushimeve të përcaktuara. Planet e ngjeshura mësimore mund të mos jenë shumë të efektshme, sepse nxënësit mbingarkohen me informacione.

Intervistat në shkolla dhe fokus grupet konfirmuan që stafi ekstra i kërkuar në udhëzimet e MAS nuk ishte punësuar. Në vend të kësaj, stafi ekzistues pritej të ofronte mbështetje shtesë, gjë e cila rezultonte në mbingarkesë të mëtejshme për ta.



“NUK KA PASUR STAF SHITESË NË SHKOLLË DHE VAJZA IME NUK ËSHTË VIZITUAR NGA NDONJË PSIKOLOG”

PRIND NGA FIERI



Të tjerë prindër raportuan se arsimimi i fëmijëve të tyre pas kthimit në Shqipëri vijoi normalisht.



“BËMË NJËSIMIN E DOKUMENTACIONIT QË PROVONTE SE FËMIJËT E MI KISHIN NDJEKUR SHKOLLËN JASHTË VENDIT DHE ATA U REGJISTRUAN NË SHKOLLË DHE E VAZHDUAN ATË NË TË NJËJTËN MËNYRË SI TË GJITHË FËMIJËT E TJERË”

PRIND NË TIRANË



Fëmijë të tjerë u regjistruan në të njëjtën klasë që ndiqnin në vendet pritëse, veçanërisht nëse ata kishin qenë jashtë vendit për një kohë të gjatë (zakonisht më shumë se një vit).

Mësues dhe psikologë të intervistuar përshkruan raste fëmijësh të kthyer që u izoluan nga të tjerët në shkollë, ose që qanin gjithë kohën. Ofrimi i pamjaftueshëm i mbështetjes psikologjike është konsideruar si një problem nga familjet, shkollat dhe stafi mbështetës psikologjik.



6. Shërbimet shëndetësore

Fletëpalosjet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe faqja e saj e internetit ofrojnë informacion mbi dokumentacioni e kërkuar dhe mbi formalitetet e tjera

që emigrantët e kthyer duhet të plotësojnë për të përfituar shërbime shëndetësore dhe për të përfituar nga skema e sigurimeve shëndetësore. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik e Autoriteti Rajonal i Shëndetit në Tiranë ofrojnë gjithashtu shërbime të mbështetjes psiko-sociale për të kthyerit dhe stafi i tyre është trajnuar në këtë fushë. Ekzistenca e këtyre shërbimeve nuk u përmend në asnjë nga intervistat me Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, në qendrat shëndetësore, ose nga vetë të kthyerit.

Ndonjëherë, prindërit e kthyer nuk arrijnë të sigurojnë marrjen e kujdesit shëndetësor për të cilin fëmijët e tyre kanë nevojë.



*“NUK E DI NËSE FËMIJA IM DUHET TË MARRË NDONJË SHËRBIM MJEKËSOR.
UNË JAM NJOFTUAR GJITHMONË NGA STAFI I QENDRËS SHËNDETËSORE NË
LIDHJE ME VAKSINIMIN, POR NUK KAM MARRË NDONJË NJOFTIM PAS KTHIMIT TIM.
NDOSHTA NUK E DINË SE JEMI KTHYER”*

PRIND NË TIRANË



Sipas Drejtorive Rajonale të Shëndetit Publik disa udhëzime janë dërguar në qendrat shëndetësore për të adresuar nevojat shëndetësore të të kthyerve, duke përfshirë regjistrimin në mjekun e familjes, pajisjen me kartë shëndeti dhe përkthimin e certifikatave nga vendet pritëse që vërtetojnë vaksinimin e realizuar jashtë.

Stafi i qendrave shëndetësore raporton se udhëzimet e vetme që kanë marrë kanë qënë që t’ju ofrojnë të kthyerve të njëjtat shërbime si pjesës tjetër të popullsisë. Kjo u konfirmua edhe nga të kthyerit, pjesëmarrës të fokus grupeve, se shërbimet aktuale të ofruara për emigrantët e kthyer nuk kishin, në të vërtetë, asnjë ndryshim.



“UNË DUHET TË PAGUAJ PËR ÇDO SHËRBIM QË MARR NË QENDRAT SHËNDETËSORE”

I INTERVISTUAR NË DIBËR



PËRFUNDIME



*“DO TË EMIGROJA PËRSËRI NËSE AUTORITETET E HUAJA
DO TË NA LEJONIN TË QËNDRONIM.
KA MUNDËSI MË TË MIRA PËR FËMIJËT TANË ATJE.
NDIHEM I PAMBROJTUR NË VENDIN TIM”*

PRIND NË DIBËR



*“DO TË DOJA TË JETOJA JASHTË, QË T’I RRSIJA FËMIJËT E MI NË NJË MJEDIS
TË QETË DHE QË ATA TË MARRIN ARSIMIMIN MË TË MIRË”*

PRIND NË FIER



*“NËSE DO TË MUNDJA [TË TENTOJA TË RI-EMIGROJA], DO TA PROVOJA PËRSËRI.
NË SHQPËRI NA MUNGOJNË SHËRBIMET BAZË”*

I INTERVISTUAR NË TIRANË



Nga të dhënat e mbledhura në kuadër të këtij hulumtimi del se familjet dhe fëmijët që kthehen nga jashtë përballen me sfida të mëdha. Në nivel qëndror dhe vendor janë ndërmarrë iniciativa për të mbështetur ri-integrimin e tyre, por çdo institucion dhe ofruer shërbimesh që i shërben këtij grupi, duhet të shqyrtojnë nëse e priorizojnë mjaftueshëm këtë grup popullate. Disa nga problematikat e evidentuara përfshijnë:

1. Mungesa e përgjithshme e informacionit të aksesueshëm. Pas periudhave deri në disa vjet jashtë vendit, të kthyerit kanë nevojë për informacione në lidhje me institucionet dhe shërbimet ku ata mund të drejtohen për të kërkuar mbështetje. Sportelet e Migracionit janë themeluar për këtë qëllim, por shumica e të kthyerve nuk janë në dijeni të ekzistencës së tyre. Shërbimet e ofruara në njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) janë më të njohura dhe

mund të ofrojnë këtë këshillë, por ata nuk duket të kenë ndërmarrë ndonjë iniciativë në ndihmë të të kthyerve.

2. Skema të kufizuara të mbështetjes financiare. Shumë nga të kthyerit e intervistuar ishin në një pozitë më të keqe financiare sesa kur u larguan nga Shqipëria dhe shumica kanë qenë jashtë vendit për më shumë se tre muaj. Për të përfituar nga skema e Ndihmës Ekonomike, pretendetët duhet të fillojnë aplikimet e tyre përsëri, edhe nëse ata ishin përfitues para se të largoheshin.

3. Vështirësitë me të cilat përballen individët dhe familjet në gjetjen e punës. Edhe pse të qenit i kthyer është një faktor që trajtohet me prioritet në asistimin për gjetjen e një vendi pune, është e diskutueshme nëse kjo ndodh. Të rinjtë që kanë ndërprerë ndjekjen e shkollimit dhe formimit profesional kur u larguan nga Shqipëria, hasin vështirësi në ri-hyrjen në tregun e punës.

4. Vështirësitë me të cilat përballen fëmijët për të arritur planin edukativ në shkollë. Ndërsa janë ndërmarrë hapa konkretë për të ndihmuar fëmijët e kthyer që të ri-integrohen në shkollë, mungesa e udhëzimeve dhe stafit shtesë për të zbatuar në mënyrë efektive planet individuale të punës, si edhe mbështetja e pamjaftueshme psiko-sociale vazhdon t'i pengojë këta fëmijë në përparimin e tyre në shkollë.

5. Vështirësitë me të cilat përballen familjet në përfitimin e shërbimeve shëndetësore. Nëse emigrantët e kthyer nuk kanë paguar sigurimin shëndetësor në Shqipëri ndërkohë që ishin jashtë vendit, ata nuk mund të përfitojnë kujdes shëndetësor falas. Në praktikë, sektori i shëndetësisë nuk duket se i trajton të kthyerit ndryshe nga të tjerët. Emigrantët, në fakt, mund të kenë nevojë për mbështetje psikologjike shtesë, duke qenë se janë larguar me shpresën për të krijuar një jetë të re jashtë vendit dhe kthehen të zhgënjyer për t'u përballur më tej edhe me sfidën për t'ia nisur nga e para.

REKOMANDIME PËR POLITIKË-BËRËSIT

Për të gjitha rekomandimet, ministrinë duhet të punojnë së bashku aty ku është e përshtatshme. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë do të lehtësojë më tej ri-integrimin e emigrantëve të kthyer dhe do të ndihmojë në sigurimin e përmbushjes së nevojave specifike të tyre për shërbime.

Të gjitha ministrinë

1. Të hartojnë politika efektive për familjet e kthyer, të cilat janë të zbatueshme deri në nivelet më të ulëta të qeverisjes. Ato duhet të përcaktojnë detyrimet / përgjegjësitë për aktorët e përfshirë, si edhe të monitorohen dhe

raportohet zbatimi dhe rezultatet e arritura prej tyre.

2. Të përgatitet një paketë informacioni rreth shërbimeve që ofrohen për familjet e kthyer, dhe të sigurohet shpërndarja e saj në familje, shkollat, qendrat shëndetësore, etj.

Ministria e Punëve të Brendshme

3. Të sigurojë fuqizimin e policisë kufitare për identifikimin e çdo të kthyeri, pasi këto pika kontrolli janë vendi më i mirë dhe me kapacitetet më të mjaftueshme për ta bërë këtë.

4. Të pajisë policinë kufitare me informacion të mjaftueshëm dhe të azhurnuar për t'u ndarë me të kthyerit në lidhje me shërbimet ekzistente dhe ku mund t'i aksesojnë këto shërbime.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

5. Të rrisë profilin e Sporteve të Migracionit për të kryer/realizuar funksionin si pika kryesore e referimit për migrantët e kthyer, duke i zhvendosur ato brenda NJQV-ve dhe duke forcuar lidhjet e tyre me të gjitha shërbimet relevante lokale, për të lehtësuar aksesin dhe riintegrimin e migrantëve.

6. Të adresojnë nevojat e familjeve të kthyer, pëtej ri-integrimit në skemën e Ndhmës Ekonomike, nëpërmjet shërbimeve të kujdesit social plotësuese, duke përfshirë angazhimin e punonjësve social dhe psikologëve për të suportuar këto familje dhe procesin e tyre të ri-integrimit.

7. Të sigurohet që Zyrat e Punës t'i japin prioritet migrantëve të kthyer dhe, nëse nuk mund të sigurohet një vend pune i përshtatshëm, të sigurojnë përfitim të menjëhershëm të pagesës së papunësisë (në përputhje me dispozitat ekzistuese ligjore) krahas trajnimit profesional për ata që nuk kanë aftësi dhe kualifikime të duhura.

Ministria e Arsimit dhe Sportit

8. Të sigurohet trajnim i vazhdueshëm i mësuesve në të gjitha aspektet e planeve individuale arsimore të fëmijëve të kthyer, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve se si t'i zbatojnë ato.

9. Të nxisë bashkëpunimin midis shkollës, qeverisë së nxënësve dhe prindërve për të krijuar një mjedis pozitiv për fëmijët e kthyer. MAS duhet t'u kërkojë shkollave të raportojnë në lidhje me:

a. si i mbështesin prindërit e këtyre fëmijëve për të arritur objektivat e përcaktuara nga mësuesit;

b. si vlerësojnë progresin me të gjithë aktorët (brenda dhe jashtë shkollës) në mbështetje të fëmijëve të kthyer, duke përfshirë vlerësimin e numrit aktual të fëmijëve, nevojat dhe arritjet e tyre, si edhe realizimin e planeve individuale arsimore.

Ministria e Shëndetësisë

10. Të sigurohet që personeli i qendrës shëndetësore të mund të identifikojë të gjithë të kthyerit dhe t'i informojë ata me saktësi për shërbimet shëndetësore që ata mund të marrin dhe nëse ato janë falas apo me pagesë.

11. Të angazhojë psikologë dhe, në bashkëpunim me punonjësit social të MMSR dhe të MAS, të ndjekin familjet dhe fëmijët e kthyer dhe të mbështesin riintegrimin e tyre përsa i përket nevojave për shërbime psikologjike dhe shëndetësore.

Bashkitë/Njësitë e Qeverisjes Vendore

12. Të zhvillojnë iniciativa dhe programe specifike dhe të dedikuara brenda NjQV-ve dhe të luajnë rolin e koordinimit lokal me institucionet e tjera për të mbështetur familjet e kthyer.